



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për rininë”(komisioni përgjegjës).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjyzi, Fidel Ylli, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Enada Kapllani dhe Klajdi Qama.

Të ftuar:

Erzen Tola – drejtor i Programimit Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Ergisa Bebja – specialiste në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri - Përsëritje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës!

Sot në rendin e ditës kemi vijimin e diskutimit dhe votimit nën për nën dhe në tërësi të projektligjit “Për rininë”.

Të ftuar kemi zotin Erzen Tola, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe zonjën Ergisa Bebja, specialiste në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore.

Në mbledhjen e shkuar të komisionit votuam nën 9, i cili kaloi në nën 10 për rininë.

Vijojmë me Këshillin Vendor të Rinisë.

Almira Xhembulla – Për nën 10 Komisioni për Çështjet Ligjore sugjeron që të ketë ndryshim me përmbajtjen si më poshtë: “Pika 1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të bashkisë.

Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;

b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;

c) propozon përmirësime të politikave vendore dhe rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;

ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë”.

Do t’i kalojmë pikë për pikë, apo ta lexoj të plotë ndryshimin që sugjerohet?

“Pika 2. Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë.

Anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Pika 3. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimi i tij miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar për atë sa është e mundur kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë”.

Ka edhe një sugjerim nga Komisioni i Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë ku thuhet: “Në fjalinë e dytë të pikës 2 të nenit 10 të hiqet përcaktimi “Për Këshillin Kombëtar të Rinisë”.

Erzen Tola – Mirëdita!

Lidhur me propozimin e Komisionit të Ligjeve, shprehem dakord, ndërsa propozimi i Komisionit të Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë mendojmë se i është referuar ish - nenit të projektligjit, kështu që mendoj se nuk duhet marrë në konsideratë, pasi është ezauruar.

Fatjona Dhimitri – Edhe nga ana e palës opozitare ka një propozim. Besoj se materialin e dispononi dhe duhet ta keni studiuar.

Lidhur me Këshillin Vendor të Rinisë propozojmë që neni të riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që ngrihet me vendim të këshillit bashkiak. Në përbërje të tij janë 5 përfaqësues të Këshillit Bashkiak, përfaqësuesi i Sektorit Rinor në bashki dhe 6 përfaqësues të organizatave jofitimprurëse rinore. Përbërja e tij ndërtohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë gjinor. Zgjedhja dhe votimi i anëtarëve nga shoqëria civile bëhet sipas rregullores së miratuar nga këshilli bashkiak në konsultim me organizatat e shoqërisë civile.

2. Këshilli kryesohet nga një prej nënkryetarëve të këshillit bashkiak sipas vendimit të këshillit.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor është 3 vjet me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë të emëruar për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë, është e ndaluar .

4. Në mbledhjet e këshillit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe drejtuesit e prefekturës, qarkut apo institucioneve në varësi të qeverisë qendrore, forumeve rinore të partive politike në territor e të tjera.

5. Këshilli Vendor Rinor miraton me konsensus rregullat e tij të funksionimit brenda 6 muajve nga ngritja e tij.

6. Detyrat e Këshillit Vendor Rinor janë:

- a) këshillon bashkinë për drejtimet e politikave dhe buxhetit për rininë;
- b) siguron që çështjet e rinisë dhe buxheti rinor përfshihen në të gjitha fushat e punës së bashkisë;
- c) i propozon këshillit bashkiak dhe bashkisë përmirësime të politikave vendore, si dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në territorin e tyre;

d) vlerëson gjendjen e të rinjve dhe zbatimin e politikave vendore dhe rinore, duke dhënë rekomandime për drejtoritë përgjegjëse të bashkisë dhe institucionet e tjera publike në territory;

e) miraton raportin vjetor të punës së bashkisë për rininë, të përgatitur nga sektori i rinisë;

f) bashkërendon dhe shkëmben të dhëna dhe informacion me Këshillin Kombëtar për Rininë;

g) ngre, sipas nevojave të tij, grupe pune për çështje të rinisë dhe përcakton përbërjen në rregulloret e tyre.

h) Këshilli Rinor mbështetet në veprimtarinë dhe aktivitetet e tij nga buxheti i bashkisë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak”.

Erzen Tola – Ne jemi kundër parimisht me këtë propozim, për arsye se ky është një organ këshillimor, që është pranë kryetarit të bashkisë dhe këshillon atë për politikat rinore.

Këtij këshilli i janë dhënë një sërë kompetencash si një organ vendimmarrës, sipas propozimit që paraqitët dhe besojmë se nuk mund t’i ketë në tagër.

Gjithashtu, lidhur me mandatet, një organ këshillimor nuk mund të mandatohet parimisht, si dhe nga përbërja. Ju keni parasysh që shumë bashki janë me një numër të vogël stafi dhe popullsie dhe 11 anëtarë të detyrueshëm për secilën bashki, nuk besojmë se është e pranueshme.

Fatjona Dhimitri – Sipas propozimit tonë, mendoj se nuk cenohet pavarësia e Këshillit Vendor të Rinisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Siç e ka detyrën këshilli kombëtar i rinisë, ashtu duhet ta ketë edhe këshilli vendor, pra këshilli vendor nuk mund t’i tejkalojë kompetencat që ka këshilli kombëtar.

Fatjona Dhimitri – Sipas propozimit të kryetarit të Komisionit të Ligjeve funksionon pranë kryetarit të bashkisë, çka do të thotë që i jep këshillit vendor nuanca politike.

Milva Ekonomi – E njëjta pyetje ishte edhe për këshillin kombëtar. Çfarë lidhje ka kjo gjëja me mënyrën se si funksionon? Kjo tregon që është më shumë funksional po të jetë pranë një entiteti, jo që ka ngjyra politike.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim propozimin e Komisionit të Ligjeve. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me shumicë votash.

Kush është dakord me propozimin e bërë nga ana e opozitës? Kundër? Abstenim?

Propozimi rrëzohet.

Vazhdojmë me nenin 11 “Organizatat rinore”.

Almira Xhembulla - Meqë jam relatore e këtij projektligji, do të kisha dashur që propozimet të m’i kishit dërguar edhe mua, thjesht për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Besoj se për momentin i keni në dispozicion, megjithatë i pranishëm është edhe përfaqësuesi i ministrisë, i cili mund të na japë një mendim lidhur këtë çështje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Almira Xhembulla - Sa i takon nenit 11, sugjeroj që në pikën 1, fjalët “organizohen apo transformohen” të hiqen. Në aspektin teknik sugjeroj që pika 2 të formulohet me këtë përmbajtje:

“Organizatrat rinore duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statusin e organizatës aktivitetet dhe veprimtari rinore;

c) të paktën 70% e anëtarëve të saj të jenë të rinj.”

Fatjona Dhimitri – Fjalën e ka përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Jemi dakord me propozimin.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim nenin 11 “Organizatrat rinore”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 12 “Organizatrat për të rinjtë”.

Almira Xhembulla – Sa i takon nenit 12 sugjeroj që në pikën 1, fjalët “organizohen apo transformohen” të hiqen. Ndërsa, në aspektin teknik me qëllim qartësimin e kriterëve të organizatës për të rinjtë, pika 2 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Organizatrat me të rinj duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitetet dhe veprimtari rinore;

c) të kenë zbatuar të paktën për një periudhë 3-vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte dhe programe me impakt të rinjtë;

ç) të mos jenë në proces falimentimi ose/edhe likuidimi.”

Ndërkohë, sugjeroj që pika 4 të kalojë si pika 3, ndërsa pika 3 të kalojë si pika 4 e nenit, duke qenë se kanë lidhje logjike.

Fatjona Dhimitri – Përfaqësuesi i ministrisë e ka fjalën.

Erzen Tola – Jemi dakord.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim nenin 12 “Organizatat për të rinjtë”. Kush është pro? Kundër? Abstenim”

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Organizata kombëtare, përfaqësuese rinore”.

Almira Xhembulla – Për nenin 13 sugjeroj të ketë ndryshime me këtë përmbajtje:

“Pika 1, Organizata kombëtare përfaqësuese rinore është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi, për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me statusin e saj.

Pika 2. Të drejtën për të themeluar organizatën kombëtare përfaqësuese rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate të rregulluara në statutin e saj.

Pika 3. Kriteret që duhet të përmbushë organizata kombëtare e përfaqësuesve rinorë për t’u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Dua t’ju sjell në vëmendje që ky është një ndër nenet që është diskutuar më gjatë, duke qenë se ka pasur disa sugjerime edhe nga organizatat, qoftë edhe nga Komisioni i Ligjeve, kështu që ne kemi bërë një diskutim të thelluar për këtë gjë. Më vjen mirë që edhe kriteret që ishin ndoshta përjashtuese për dikë, por qoftë edhe diskutimi që kjo të kalohet me vendim të Këshillit të Ministrave, është diçka shumë pozitive, për të mos pasur probleme sa i përket organizatës kombëtare përfaqësuese rinore.

Fatjona Dhimitri – Përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Jemi dakord me propozimet që ka bërë Komisioni i Ligjeve.

Fatjona Dhimitri – Zoti Tola, unë mendoj se duhet hequr neni 13, gjë që e kemi ridiskutuar sërish, pasi nuk është e nevojshme që të krijohet një organizatë ombrellë për organizatat e tjera, kur mund të ketë tri rrjete rinore, të cilat dëshirojnë të krijojnë partneritet me ministrinë për veprimtaritë e tyre. Unë mendoj se krijimi i një organizate të tillë ombrellë e cenon marrëdhënien midis këtyre rrjeteve rinore apo ndërmjet organizatave të tjera. Pra, përveç këtyre rrjeteve rinore,

ne mund të kemi edhe shumë organizata të tjera, të cilat dëshirojnë të krijojnë partneritet me ministrinë.

Erzen Tola – Faleminderit, zonja kryetare, por nëse e shohim nenin e propozuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, kjo pikë është diskutuar në atë komision dhe është sqaruar që organizatat mund të jenë më shumë se një, kriteret do të përcaktohen me VKM dhe organizatat përfaqësuese ombrellë mund të jenë më shumë se një, edhe në varësi të tematikave, mjafton të plotësohen kriteret që do të përcaktojnë.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim nenin 13. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Para se të kalojmë te kreu 3, që është puna rinore, kam një propozim për të shtuar një nen te ky kapitull: “Drejtuuesi i sektorit për rininë në bashki emërohet ose, sipas rastit, caktohet nga kryetari i bashkisë. Ai/ajo është përgjegjës ndër të tjera për këto detyra:

- a) koordinon dhe zbaton politikat, strategjitë, planet vendore dhe aktivitetet e bashkisë për rininë në bashkëpunim dhe koordinim me organizatat dhe grupimet rinore në territor;
- b) merr masa për zbatimin e politikave rinore kombëtare, duke i bërë ato pjesë të politikave, strategjive, planeve dhe aktiviteteve vendore të veprimit;
- c) koordinon, bashkëpunon dhe mbështet bashkinë dhe drejtoritë e saj, që punojnë për çështjet e rinisë, për të zbatuar politikat, strategjitë, planet vendore dhe aktivitetet e bashkisë për rininë;
- d) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me koordinatorin kombëtar të rinisë dhe Shërbimin Kombëtar të Rinisë;
- e) orienton biznesin dhe donatorët në territor për zbatimin e objektivave të politikave, strategjive, planeve vendore dhe aktiviteteve të bashkisë për rininë;
- f) koordinon zbatimin e politikës vendore rinore në bashkëpunim dhe duke mbështetur organizatat jofitimprurëse të të rinjve, strukturave këshillimore rinore në njësinë e qeverisjes vendore, forumet politike të të rinjve, të partive politike, grupimet rinore etj;
- g) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të këshillit rinor në bashki;
- h) mbledh, analizon dhe bën publike të dhënat statistikore për rininë në bashki;

i) përgatit raportin vjetor të punës së bashkisë për rininë;
j) mbështet punën dhe aktivitetet e organizatave joqeveritare për rininë në territor, sipas procedurave të bashkisë;

k) zbaton çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër të caktuar nga këshilli bashkiak dhe bashkia”.

Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke pasur parasysh që bëhet një përcaktim i tillë për një sektor në njësitë vendore, gjykojmë se kështu ndërhyjmë në autonominë e njësive të vetëqeverisjes vendore, sepse nuk mund të përcaktojmë me ligj funksionin për sektor, pasi ato janë institucione të pavarura kushtetuese.

Në projektligjin që kemi propozuar, në nenin 7, përcaktohet që bashkitë kanë detyrimin të ngrenë struktura rinore në varësi të organizimit të tyre të brendshëm, sepse gjykojmë që Bashkia e Tiranës, duke qenë më e madhja, mund të ketë drejtori strukture për rininë, ndërsa një bashki e vogël mund të ketë një specialist ose një sektor. Kështu që gjykojmë që ky propozim është në tejkalim të parashikimeve kushtetuese lidhur me kompetencat e njësive dhe të qeverisjes vendore.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë, pra për shtimin e nenit.

Kush është dakord?

Rrëzohet.

Kalojmë te kreu 3 “Puna rinore”.

Almira Xhembulla – Nga Komisioni i Ligjeve sugjerohet që titulli i nenit të bëhet “Puna rinore”, se është “Puna rinore dhe punonjësi rinor” dhe në vijim të rekomandimeve për germën “dh” të nenit 2, lidhur me përkufizimin e punonjësit rinor, i rekomandohet komisionit përgjegjës të shohë heqjen e parashikimeve të pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

Fatjona Dhimitri – Po, përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Ne shprehemi dakord me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, pasi edhe në atë komision është diskutuar shumë gjatë dhe, duke qenë se nga përkufizimet është hequr “punonjësin rinor”, shprehemi dakord edhe me heqjen në këtë kre të “punonjësit rinor”, duke e lënë “Puna rinore”.

Fatjona Dhimitri – Atëherë një propozim për riformulim nga ana e palës sonë lidhur me pikën 2: “Puna rinore realizohet përgjithësisht në qendra rinore nëpërmjet angazhimit dhe aktivizimit të të rinjve në veprimtari që reflektojnë nevojat, interesat, idetë dhe eksperiencat e

tyre”. Pra, kuptohet që pjesa më e madhe e aktiviteteve të të rinjve realizohet në qendra rinore, përmes mbështetjes së tyre dhe bashkëpunimit me punonjësit rinorë.

Erzen Tola – Ne parimisht nuk jemi kundër këtij propozimi, por terma të tillë nuk përdoren përgjithësisht në projektligj.

Fatjona Dhimitri – Nuk mendoj se është ndonjë problem i teknikës legjislative.

Erzen Tola – Në projektligj ne e kemi përcaktuar që puna rinore realizohet nëpërmjet angazhimit dhe aktivizimit të të rinjve në të gjitha aspektet dhe vendet, kështu që nuk besoj se mund të përdorim terma kufizues vetëm në qendra rinore.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, pikat 3,4 dhe 5 janë propozuar që të hiqen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po themi te përkufizimet.

Unë e propozova dje një gjë të tillë, po zoti Tola nuk e pranoi, te “puna rinore”, që ta kalonim te përkufizimet.

Gazmend Bici – ...te pika 1 tregohet se çfarë është puna rinore dhe çdo veprimtari, prandaj mendoj se duhet të kalojë te përkufizimet.

Fatjona Dhimitri – Dje është bërë një propozim i tillë, por nga ana e ministrisë nuk u pa e arsyeshme që të kalonte te përkufizimet.

Gazmend Bici – Tregon së çfarë përshkruan, pra, thelbi ky është.

Fatjona Dhimitri – Po, përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Ne mbetemi për variantin e propozuar nga Këshilli i Ministrave, që përcaktimi i punës rinore të mbetet në nen, pra çfarë është puna rinore, dhe jo të jetë me përkufizim.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim nenin 14.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kuptohet se, nëse unë nuk i përmend rekomandimet, u referohem gjithmonë ndryshimeve të sjella nga Komisioni i Ligjeve dhe nga komisionet e tjera që kanë dhënë mendim.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Me 1 votë kundër dhe me shumicë votash pro, miratohet.

Pra, tre propozimet nuk miratohen.

Përpara se të kalojmë te kapitulli i katërt, te financimi, zoti Tola, mendoj të shtojmë disa nene.

Erzen Tola – A mund ta sqaroj paraprakisht?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Erzen Tola – E shikoj se është termi “punonjësi rinor” në vijim, por deri tani komisioni ka votuar dhe i ka rrëzuar të gjitha përcaktimet për punonjësin rinor; nuk e di nëse do të ishte e nevojshme ta lexojmë propozimin.

Fatjona Dhimitri – Lidhur me një shtesë neni për qendrat rinore, mendoj të kemi një nen të veçantë për qendrat rinore:

“1. Në çdo njësi të qeverisjes vendore hapen qendra rinore. Qëllimi i qendrave është mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve dhe të rejave me shërbime komunitare të mbrojtjes, këshillimit, zhvillimit arsimor joformal dhe të karrierës, si dhe për organizimin e aktiviteteve rinore nëpërmjet punës me të rinjtë.

2. Qendrat rinore mbështeten dhe financohen në aktivitetet e tyre nga njësia e qeverisjes vendore që administron territorin ku ata ndodhen. Staf i tyre është në varësi të sektorit të rinisë në bashki.

3. Struktura, roli, funksionet, menaxhimi dhe shërbimet bazë që ofrojnë qendrat rinore përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet rinore, në konsultim me njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare rinore.

4. Personeli që punon drejtpërsëdrejti me të rinjtë në qendër do të konsiderohet “punonjës rinor”. Punonjësit rinor bashkëpunojnë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tyre në sektorin e rinisë në bashki, si dhe në Shërbimin Kombëtar të Rinisë. Shërbimi Kombëtar për Rininë, brenda 6 muajve nga hyrja e ligjit në fuqi, propozon për miratim në Këshillin Kombëtar të Rinisë modelin e qendrës rinore me konsultim të gjerë me ministrinë përgjegjëse për rininë, njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare”.

Sërish do të thoni se e kemi hequr termin “punonjësit rinor”, por nuk mendoj se përbën problem për shtesën në këtë ligj.

Erzen Tola – Ne pranojmë çdo propozim, por mendojmë se ky propozim vjen në kundërshtim me projektligjin e propozuar, sepse në projektligj qendrat rinore i kemi trajtuar si infrastrukturë rinore, pra jo si sektorë ose si institucione. Meqenëse është trajtuar si infrastrukturë rinore, mund të mos jetë vetëm qendër rinore, por mund të jenë edhe forma të tjera që organizojnë të rinjtë. Prandaj mendojmë që ta lëmë sipas variantit të projektligjit të propozuar.

Almira Xhembulla – Atëherë kalojmë te ...

Fatjona Dhimitri – Përpara se të kalojmë, kisha edhe diçka tjetër. Lidhur me një shtesë neni tjetër “Komisioneri për të drejtat e të rinjve”. Ne përsëri po diskutojmë nevojën për të pasur një nen në këtë projektligj për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, në rast se do të shkelen. Pra, të rinjtë të kenë një institucion të pavarur, ku të ankohen në rast se shkelen të drejtat e tyre.

Formulimi i nenit: “Pranë zyrës së Avokatit të Popullit krijohet Komisioneri për të drejtat e të rinjve. Roli dhe funksioni i komisionerit përcaktohen me ligjin “Për Avokatin e Popullit””.

Erzen Tola – Unë mendoj se ky propozim është në kundërshtim me ligjin “Për Avokatin e Popullit”, sepse ai ligj nuk përmban tekst për komisioner të veçantë. Avokati i Popullit është për të gjithë popullatën, pra për të gjitha grupmoshat dhe problematikat e tyre. Komisionerët organizohen në varësi të organizimit të brendshëm të institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk mund të krijojnë komisioner apo struktura të veçanta për ligje të posaçme. Nuk e kuptoj.

Fatjona Dhimitri – Përpara se të kalojmë te financimi, mendoj të shtojmë edhe një nen: “Praktika e punës së të rinjve. Të rinjtë në përfundim të shkollës së mesme, gjatë ose pas përfundimit të periudhës së studimeve universitare, mund të zhvillojnë praktika pune në institucione shtetërore, organizata joqeveritare ose biznese. Praktika e punës së të rinjve bëhet vetëm përkundrejt pagesës së personit që ushtron praktikën, për orët e punës të realizuara gjatë praktikës dhe nuk lejohen praktikat e punës së papaguara për të rinjtë”.

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Të rinjtë që duan të përfitojnë nga praktika e punës, duhet të lidhin kontratë me Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Shërbimi i bazuar në kërkesat e të riut/resë përcakton oraret e punës në bashkëpunim me institucionin shtetëror, organizatën joqeveritare ose biznesin ofrues të praktikës së punës. Çdo fillim viti, Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Rinisë përcaktojnë fushat prioritare për institucionet, organizatat dhe bizneset ku do të organizohet praktika e punës dhe kohëzgjatja e tyre. Shërbimi Kombëtar i Punësimit lidh kontrata bashkëpunimi me institucione publike, organizata joqeveritare dhe biznesin, të cilat duan të bëhen pjesë e shërbimit të praktikës së punës së të rinjve. Pagesa e të rinjve bëhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Rinisë krijojnë dhe mirëmbajnë së bashku regjistrin kombëtar të praktikave të punës së të rinjve. Rregullat për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullat e bashkëpunimit nëpërmjet Shërbimit dhe të rinjve, institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe biznesit ofrues të praktikës së punës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për rininë. Çdo subjekt, që ofron praktika të punës për të rinjtë, ka detyrë të marrë të gjitha masat objektive të mundshme për të eliminuar çdo rrezik ose ngjarje që mund të rrezikojë jetën ose mirëqenien fizike, emocionale ose seksuale të të riut ose të resë.”

Mund të them se nevoja për një nen të tillë në këtë projektligj parashtrohet nga kërkesa e të rinjve shqiptarë anembanë vendit, të cilëve tregu i punës u injekton bërjen e një praktike profesionale ose të punës. Kështu që i riu formësohet drejt një profesioni të ri.

Mirë është që këto praktika të jenë të paguara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Lidhur me propozimin, konsideroj përsëri se ka një problematikë ligjore, sepse të gjitha praktikatat e punës, që lidhen me profesionet e rregulluara, sepse vetëm kuadri ligjor për profesionet e rregulluara kërkon praktika të detyrueshme pune, kanë një rregullim të posaçëm në ligjin e përgjithshëm të profesioneve të rregulluara dhe pastaj në ligjet e veçanta për ngritjen e secilit urdhër të profesioneve të rregulluara. Në këtë kuadër ligjor, është e përcaktuar kohëzgjatja e praktikave, mënyra e pagesës apo edhe praktikatat e papaguara e kështu me radhë.

Ndërsa lidhur me praktikën e të rinjve, Këshilli i Ministrave ka aplikuar një politikë disavjeçare që punëson të rinj praktikantë për 1 vit praktikë pune në institucionet shtetërore. Për këtë arsye është bërë me vendim qeverie dhe jo me ligj, pikërisht për të mos rënë ndesh me përcaktimet e kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara.

Fatjona Dhimitri – Përpara se të kalojmë te financimi, po i hedh në votim nenet e propozuara. Kush është dakord me këto nene?

Propozimet rrëzohen.

Vijojmë me kreun IV “Financimi”, te neni 15.

Urdhëroni!

Almira Xhembulla – Atëherë, për nenin 15 nga Komisioni i Ligjeve sugjerohet që pika 3 të ndryshohet me përmbajtjen, si më poshtë: “Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuara për rininë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Fatjona Dhimitri – Cili është mendimi nga përfaqësuesit e ministrisë?

Erzen Tola – Shprehemi dakord me propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Fatjona Dhimitri – Hedhim në votim nenin 15 “Burimet e financimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 16 “Financimi i politikave, programeve dhe projekteve rinore”.

Urdhëroni!

Almira Xhembulla – Fjalja hyrëse e pikës 1 të nenit 16 sugjerohet të riformulohet si më poshtë: “1. Fondi grant i dedikuar për rininë, sipas germës “a” të pikës 1 të nenit 15, të këtij ligji përdoret vetëm” dhe vazhdon siç është në draftin e parë.

Ndërsa pika 2 sugjerohet të riformulohet si më poshtë: “2. Projektet e ndërtimit ose të rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore paraqiten dhe miratohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke garantuar zbatimin e elementeve të përshtatjes së arsyeshme sipas legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Pas pikës 2, sugjerohet të shtohen pikat 3 dhe 4 me përmbajtjen si më poshtë vijon: “3. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të shpërndarjes së fondeve grant të dedikuara për rininë, procedurat e përzgjedhjes, kontratat e nënshkruara me organizatat përfituese, si dhe raportimet për shpenzimin e fondeve të dhëna, sipas këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të institucionit përgjegjës për rininë. 4. Institucioni përgjegjës për rininë shkëmben informacion me institucionin përgjegjës për mbështetjen e shoqërisë civile, për organizatat për të rinjtë përfituese të fondit grant të dedikuar për rininë”.

Fatjona Dhimitri – Cili është mendimi nga përfaqësuesit e ministrisë?

Erzen Tola – Shprehemi dakord me propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Fatjona Dhimitri – E hedhim në votim nenin 16. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Para se të kalojmë te kreu V “Infrastruktura rinore”, kam një propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dua të shtoj një nen te buxheti për rininë: “Fondet për programet e financimit dhe projektet me interes publik në sektorin e rinisë do të rezervohen në një zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për rininë dhe të njëjset të qeverisjes vendore. Këto fonde do të përdoren për: a)

zhvillimin e aktiviteteve rinore nëpërmjet inkurajimit të të rinjve për pjesëmarrje aktive në proceset demokratike dhe sociale; b) fuqizimin e rrjeteve, organizatave dhe grupimeve rinore për të marrë pjesë në zbatimin e aktiviteteve dhe objektivave të rinisë, të përcaktuara në strategjitë dhe planet e veprimit për rininë”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jam në faqen 21, zoti Tola, besoj po më ndiqni!

“...c) informimin e të rinjve; d) përgatitjen dhe botimin e botimeve me rëndësi për të rinjtë; e) mbështetjen e qendrave rinore, punonjësit rinorë dhe shërbimet e tyre; f) organizimin e trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve për punësimin, vetëpunësimin dhe sipërmarrjen rinore; g) nxitjen e edukimit joformal të të rinjve; h) fuqizimin shoqëror të të rinjve, veçanërisht nëpërmjet inkurajimit të vullnetarizmit dhe punës me të rinjtë, si dhe ngritjes së kapaciteteve të organizatave rinore; inkurajimin e të rinjve për të qenë aktivë dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme dhe të sigurt, si dhe trajtimin e nevojave të të rinjve në fushën e sportit dhe të kulturës; j) inkurajimin e aktiviteteve rinore në nivel lokal, nëpërmjet mbështetjes dhe zbatimit të planeve lokale të veprimit për të rinjtë, si dhe programeve dhe projekteve të sektorit të rinisë dhe qendrave rinore; k) kryerjen e studimeve për gjendjen, pozitën dhe nevojat e të rinjve në Shqipëri; l) promovimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të të rinjve në rajon me të rinjtë, që jetojnë në Bashkimin Europian apo dhe më gjerë; m) krijimin dhe zbatimin e kartës rinore.

2. Procedurat dhe rregullat për shpërndarjen e fondeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Sërish nuk mendoj se duhet të ketë një përcaktim të tillë për fondet buxhetore. Programet buxhetore përcaktohen çdo vit në ligjin e buxhetit të vitit përkatës, si dhe mënyra e shpenzimit të tyre përsëri përcaktohet në ligjin e buxhetit. Kështu që mendoj se është e tepërt të përcaktohen në këtë projektligj.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, e hedhim në votim propozimin.

Kush është dakord me propozimin?

Po, urdhëro!

Bujar Çela – Është rast i rrallë, sepse unë e mbështes të vërtetën, që jam shumë dakord me propozimin tuaj.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, e hedhim në votim propozimin e buxhetit për rininë.

Kush është dakord me propozimin?

Propozimi rrëzohet.

Kalojmë te “Infrastruktura rinore”.

Almira Xhembulla – Nuk kemi ndryshime për nenin 17.

Fatjona Dhimitri – Kush është dakord me nenin 17? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 “Baza e të dhënave për rininë” te dispozitat e fundit.

Almira Xhembulla – Atëherë, për nenin 18 kemi një sugjerim.

Në pikën 3 fjalët “...sipas rregullave të koordinimit të përcaktuara nga Autoriteti Rregullator Koordinues” të zëvendësohen me fjalët “...sipas legjislacionit në fuqi”. Pas pikës 3 sugjerohet të shtohen pikat 4 dhe 5 si më poshtë:

Pika 4: “Rregullat e hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyra e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pika 5: “Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale sipas parashikimeve të këtij neni bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Fatjona Dhimitri – Po, përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Shprehem dakord me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, e hedhim në votim nenin 18 “Baza e të dhënave për rininë”.

Kush është dakord me nenin 18?

Miratohet neni 18.

Kalojmë te neni 19 “Miratimi i akteve nënligjore”.

Almira Xhembulla - Në nenin 19 kemi një rekomandim që të shikojmë afatin e nxjerrjes së akteve nënligjore.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Po, përfaqësuesi i ministrisë.

Erzen Tola – Sërish shprehem dakord me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, pasi atje diskutuam dhe gjykuam se afati prej 9 muajsh ishte shumë i gjatë dhe aktet duhet të dilnin më shpejt. Ne ramë dakord që të propozojmë dhe t’i miratojmë brenda afatit që do të përcaktojë ligji.

Fatjona Dhimitri – Afati është lënë 6 muaj.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 19.

Kush është dakord me nenin 19? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë te neni 20 “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord me nenin 20? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për rininë”.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për rininë”? Dakord!

Miratohet me shumicë votash projektligji “Për rininë”.

Kostaq Papa - A mund të them diçka të fundit?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Kostaq Papa - Ligji “Për rininë” ka nevojë për një saktësim pas rregullimeve dhe ndërhyrjeve të komisionit. Boshti i ligjit për organizimin rinor duhet të jetë këshillimor, sepse përndryshe rinia del si një levë e pushtetit.

Në disa nene ne kemi vënë institucione të tjera qendrore dhe të tjera pushtetit lokal. Pra, edhe pse flasim për ligjin “Për rininë”, në etiketimin e neneve të gjithë flasim sikur jemi në institucione të tjera qendrore apo lokale. Këto institucione duhen parë nga këndvështrimi i ligjit “Për rininë”. Për shembull, në nenin 7 ne themi “Njësia e vetëqeverisjes vendore”, ndërkohë që ne jemi te ligji “Për rininë”, por, duke e parë nga këndvështrimi për rininë, duhet të shikojmë predispozimin në lidhje me vetëqeverisjen vendore.

Po kështu, te neni 16, edhe pse kishte njëfarë formulimi që i përkiste ligjit “Për rininë”, ne e transformuam dhe doli sikur po flisnim për një institucion buxhetor.

Fatjona Dhimitri – A keni tjetër gjë për projektligjin?

Kostaq Papa - Nuk kam përfunduar ende.

Fatjona Dhimitri – Këto duhet t’i kishit thënë kur diskutuam nen për nen.

Kostaq Papa - Unë kam të drejtën time të flas.

Fatjona Dhimitri – Këto thuajini në seancë.

Kostaq Papa - Në seancë thuajti ti, sepse unë e kam radhën tani. Ti nuk ke të drejtë të ma ndërpresësh fjalën.

Pra, sot pas votimeve fantazmë, duket sikur pushtetin vendor e zotëron vetëm maxhoranca dhe sikur organizmat rinorë janë leva të bashkisë apo të partisë si një monoparti.

Së pesti, mbeten pa u definuar koncepte dhe formulime në organizimin e politikave dhe veprimtarive, sepse, në fund të fundit, ky ligj, organizatat rinore i kthen në leva partiake.

Së gjashti, ligji është një përpjekje e mirë, por jo i mirë për t'i sjellë veprimtari të pavarura rinisë. Me gjithë dëshirën e mirë, unë e abstenoj ligjin.

Fatjona Dhimitri – Pas votimit në tërësi të projektligjit, nëse nuk ka gjë tjetër për të shtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA